



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivery	02.11.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHCK	6658/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr.804/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani -kryetar, Ardita Haxhnikaj – Demi dhe Jeton Koca, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.804/2022 të datës 19.09.2022, të parashtruar nga ankuesi nga Komuna e Gjilanit, kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “Masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.804/2022 të datës 19.09.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokolli:6886 i datës 08.09.2022 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

A r s y e t i m

Ankuesit sipas shkresave të lëndës i punësuar në Agjencinë e Veterinës dhe Ushqimit, Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, përmes Vendimit të datës 08.09.2022 me numër rptokolo:6883 i ka shqiptuar masën disiplinore “ndalim 20% e pagës për periudhën tre (3) muaj”.

Ankuesi, kundër Vendimit të datës 08.09.2022 Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se procedura disiplinore është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, ndërsa

masa e shqiptuar disiplinore është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Ndërsa Këshilli me datë 03.10.2022, ka pranua nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, përgjigjen në kërkesë me numër protokoll:5825/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.10.2022, me numër protokoll 6164/2022, ka nxjerr vendim me të cilin ka bere bashkimin e lëndës të Ankesës A. Nr. 761/2022 të datës 02.09.2022 ankesë e cila ishte bërë kundër inicimit të procedurës disiplinore si dhe ankesës A. Nr. 804/2022 e datës 19.09.2022 lidhur me shqiptimin e masës disiplinore, për arsye së procedura në tërsi bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 804/2022 të datës 19.09.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; A. Nr. 761/2022 të datës 02.09.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e- maili i datës 17.08.2022; Vendimi i datës 08.09.2022, me numër 6883, i Komisionit Disiplinor; Kërkesë e datës 10.08.2022, për inicimin e procedurës disiplinore; Procesverbali i datës 30.08.2022, i Komisionit Disiplinor; e- maili i datës 22.08.2022; e- maili i datës 24.08.2022; ; e- maili i datës 29.08.2022; e- maili i datës 31.08.2022; e-maili i datës 06.09.2022; e- maili i datës 13.09.2022; Akt Emërimi i datës 08.07.2013; Përshkrimi i detyrave të Punës; Ankesë e datës 09.08.2022; Deklaratë e datës 17.08.2022; e-maili i datës 17.08.2022; Deklaratë (dëshmi) e datës 18.08.2022; Deklaratë e datës 18.08.2022; Deklaratë e datës 18.08.2022; Përgjigje në ankesë e datës 03.10.2022, me numër protokoll 5825/2022, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *pabazuar*, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 08.07.2013 me numër:2999/1 është i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës në pozitën e punës "Kordinator i Zyrës Regjionale në Gjilan" në kuadër të Departamentit të Inspektoratit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, ndërsa udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë me datë 10.08.2022 i është drejtuar Komisionin Disiplinor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës me kërkesën për inicimin e procedurë disiplinore me sugjerimin se ankuesi ka kryer shkelje të detyrave të punës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, përmes Vendimit të datës 08.09.2022 me numër rptokolo:6883 i ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim 20% e pagës për periudhën tre (3) muaj" me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 në paragrafi 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ngase ankuesi kishte ushtruar sulm fizik ndaj nëpunësit civil, kolegut të tij



Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjit material që përcaktojnë kryerjen e shkeljeve disiplinore, dhe rregullojnë kompetencën për shqyrtimin e masave disiplinore, gjegjësisht ka analizuar nenin 46 paragrafi 3 në paragrafi 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi"*, po ashtu ka analizuar nenin 48 paragrafi 3 dhe nenin 47 paragrafi 1 në paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor. Neni 47, Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se për masën e shqiptuar disiplinor është në kompetencë të Komisionit Disiplinor, ndërsa masa e shqiptuar disiplinore është masa më e lehtë që mund t'i shqiptohet nëpunësve civil me rastin e kryerjes së shkeljeve të rënda disiplinore.

Kolegji i Këshillit me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike dhe analizimit të ligjshmërisë së Vendimit të datës 08.09.2022 me numër rptokolo:6883 të Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ka analizuar deklaratat e nëpunësve civil, si vijon; deklaratën e datës 17.08.2022 dhënë nga nëpunësi civil B.S në cilësi të dëshmitarit, deklaratën e datës 18.08.2022 dhënë nga nëpunësi civil F.S në cilësi të dëshmitarit, deklaratën e datës 18.08.2022 dhënë nga nëpunësi civil I.V në cilësi të dëshmitarit, deklaratën e datës 18.08.2022 dhënë nga nëpunësi civil N.M në cilësi të dëshmitarit, raportimin e rastit nga i dëmtuari të datës 09.08.2022 dhe ka ardhur në përfundimin se sipas dëshmimeve të dëshmitarëve ankuesi ka qenë iniciuesi dhe ai që ka filluar fillimisht konfliktin ndaj kolegut të tij rrjedhimisht Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit ka vepruar në pajtueshmëri me kompetencën që ka të përcaktuar me nenin 48 paragrafi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, pasi që ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike ngase ankuesi ka konsumuar elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuara nga nenin 45 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"* ngase nëpunësit civil janë të obliguar ligjërisht të jenë të përgjegjshëm në punë siç përcaktohet me nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij"* si dhe me nenin 25 paragraf 3 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike"*, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit Konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara ndërsa vendimi i Komisionit Disiplinor i goditur me këtë ankesë mbetet në fuqi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.



Po ashtu Kolegji i Këshillit, ka konstatuar Komisionin Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 08.09.2022 për shqiptimin e masës disiplinore ka vepruar në pajtim edhe me nenin 12 paragrafin 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se: " Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore" ngase inicimi i procedurës është bërë me datë 10.08.2022, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor vendimin e kontestuar me këtë ankesë e ka nxjerrë në ditën e 29 (njëzet e nëntë) brenda afateve kohore, sikurse Komisioni Disiplinor ka mbajtur dy (2) seanca me datë 19.08.2022 dhe datë 05.09.2022 përmes të cilave ankuesit i është dhënë mundësia të shpreh variantin e tij të ngjarjes, andaj edhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit vlerëson se procedura e zhvilluar disiplinore është bërë në pajtueshmëri me nenin 12 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik si dhe në pajtim edhe me nenin 11, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1,dhe 1.2 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku thuhet se; 1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore", ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me lëshime procedurale nga ana e institucionit punëdhënës janë të paqëndrueshme.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.804/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së